

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Albanian YouTubers" Sh.p.k.

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Civil, në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, dhe në ligjin Nr. 9723, datë 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, të nënshkruarit si vijon:

- a) Anaid Kaloti, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BJ3349245, me numër personal identifikimi I50709072G i datëlindjes 09.07.1985, lindur në Tiranë dhe banues në rruga Skenderbeg Vila1, Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- b) Erion Zeqiraj, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BR5404814, me numër personal identifikimi I50126073N, i datëlindjes 26.01.1985, lindur në Permet dhe banues në adresën: Rruga Prokop Mima Nd.27, H2 Ap 9, Njesia Administrative 1019 Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- c) Jetmir Salaj, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BC741446J, me numër personal identifikimi I41219074M i datëlindjes 19.12.1984, lindur në Vlorë dhe banues në 1007 Avenue RD, Toronto Kanada; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- d) Kleanthi Hysa, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të Leternjoftimit me numër 038306492, me numër personal identifikimi I30916051A i datëlindjes 16.09.1983, lindur në Burrel dhe banues Rruga Fadil Rada, Pallati i Telebingos, Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- e) Vesel Kurtishaj, shtetas Kosovar, identifikuar me anë të pasaportës me numër P00666458, me numër personal identifikimi 1232128468 i datëlindjes 13.10.1993, lindur në Suharekë dhe banues në Suharekë, Rruga "Pusi i atit"; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

në cilësinë e Themeluesve dhe Ortakëve të shoqërisë, me vullnet të plotë e të lirë nënshkruan, sot më datë 13.06.2023, Akt Themelimit (të inkomporuar në këtë Statut) me qëllim themelimit e kësaj shoqërie sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

1.2 Emri i shoqërisë është "Albanian YouTubers" Sh.p.k.

1.3 Shoqëria themelohet sot, më datë 13.06.2023 në Tiranë, Shqipëri. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.





1.4 Shoqëria "Albanian YouTubers" Sh.p.k., (këtu e në vijim referuar si "Shoqëria") është e themeluar dhe organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe aktiviteti i saj rregullohet nga ky Statut dhe ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

1.5 Shoqëria do të operojë në përputhje të plotë me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Objekti i Veprimtarisë

2.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë bazuar në legjislacionin shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar në:

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Albanian YouTubers" shpk



- Studio dhe Produksione Podcasting;
- Produksione për dhe në platforma on-line;
- Shërbime të ndryshme në fushën e medias vizive, te shkruar dhe elektronike,
- Kanal YouTube;
- Kanale komunikimi on-line në platforma te tjera;
- Produksion reklamash, spotesh televizive, organizim eventesh, komunikim dhe marketing;
- Prodhimin dhe tregtimin e materialeve promocionale dhe reklamuese;
- Strategji marketingu, Promovim biznesesh dhe aktiviteteve në media on-line, në media audio-vizive, në media sociale;
- Prodhime software dhe aplikacionesh të ndryshme;
- Import mallrash të ndryshme;
- Shitje me shumicë e pakicë;
- Shitje on-line;

si dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me realizimin e objektit të aktivitetit të shoqërisë.

2.2 Për realizimin e objektit të sipërpërmendur shoqëria mund të lidhë marrëveshje apo kontrata qiraje, shitblerje a hipotekimi të pasurive të paluajtshme, kontrata kredie, shërbimi dhe marrëveshje a kontrata të tjera të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit.

Neni 3 Përgjegjësia

3.1 Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emër dhe për llogari të tyre ndaj personave të tretë.

Neni 4 Kohëzgjatja

4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar.

Neni 5 Selia

- 5.1 Shoqëria e ka selinë në adresën: "Rruga Sami Frasheri, Apartamenti nr 8", ZK 8380 Nr. pasurisë: 7-467-N8, volumni 29, faqe 199, Tiranë.
- 5.2 Me vendim të organit vendimmarrës, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 5.3 Adresa elektronike për qëllime komunikimi zyrtar: albtubers@gmail.com

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 2137600 (dymilion e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) Lekë, i ndarë në 5 (pesë) kuota me vlere nominale 427520 Lekë (katërqind e njëzetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzetë) Lekë.
- 6.2 Pjesëmarrja e secilit ortak ne kapitalin themeltar është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Albanian YouTubers" shpk

- a) Ortaku themelues Anaid Kaloti, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 427520 Lekë (katërqind e njëzetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzetë) Lekë, që përbën 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - b) Ortaku themelues Erion Zeqiraj, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 427520 Lekë (katërqind e njëzetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzetë) Lekë, që përbën 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - c) Ortaku themelues Jetmir Salaj, zotërues i zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 427520 Lekë (katërqind e njëzetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzetë) Lekë, që përbën 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - d) Ortaku themelues Kleanthi Hysa, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 427520 Lekë (katërqind e njëzetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzetë) Lekë, që përbën 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - e) Ortaku themelues Vesel Kurtishaj, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 427520 Lekë (katërqind e njëzetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzetë) Lekë, që përbën 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- 6.3 Kontributi i ortakëve do të jete në vlerë monetare, nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortakët në raport me përqindjen zotëruese në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 7.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar sipas kërkesës së Asamblesë së Ortakëve.
- 7.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 7.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 7.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8

Transferimi i Kapitalit

- 8.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) shitblerjes;
 - b) trashëgimisë;
 - c) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 8.3 Transferimi i kuotave të shoqërisë dhe e drejta e ortakëve për t'u larguar nga shoqëria i nënshtrohen kufizimeve të parashikuara në nenet e këtij statuti.
- 8.4 Transferimi i kuotave duhet të kryhet me shkrim, përndryshe është i pavlefshëm.

Neni 9

E Drejta e Parablerjes

- 9.1 Pa çënuar kufizimet dhe kushtet e parashikuara në Ligjin 9901, datë 14 prill 2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ortaku që dëshiron t'i transferojë të tretëve të gjithë apo një pjesë të kuotës

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Albanian YouTubers" shpk

së tij në shoqëri, apo çdo të drejte lidhur me të sipas ligjit, në çfarëdo forme dhe titulli, duke përfshirë, dhurimin, kontributin në natyrë apo shkëmbimin, do t'i komunikojë qëllimin e tij ortakëve të tjerë dhe Administratorit me letër të drejtuar në seli dhe në adresat zyrtare të ortakëve me mjetet e komunikimit zyrtar të miratuara nga shoqëria. Ky komunikim do të përshkruajë në mënyrë të hollësishme natyrën e transferimit, do të përcaktojë saktë kuotën dhe/ose të drejtat lidhur me të që do të transferohen, si dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme për identifikim e saktë të blerësit, do të përcaktojë çmimin e ofruar të transferimit, i cili nuk duhet të jetë më i lartë se vlera e kapitalit që zotëron ortaku në kohën që kryhet transferimi, mënyrat, kushtet dhe afatet e pagesës dhe garancitë e mundshme dhe së fundmi do të përmbajë edhe ofertën për t'ia transferuar kuotën ortakëve të tjerë sipas të njëjtave kushte me ato të parashikuara në komunikim.

9.2 Transferimi i kuotës do t'i nënshtrohet në çdo rast të drejtës së parablerjes nga ortakët e tjerë. Pa cenuar detyrimin e njoftimit të ortakëve të tjerë sipas paragrafit të këtij neni, e drejta e parablerjes nuk zbatohet në rast transferimi të kuotës midis ortakëve. Po ashtu, e drejta e parablerjes nuk zbatohet në rastin kur blerësi është një shoqëri e kontrolluar nga ortaku transferues.

9.3 Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i ortakut sipas nenit 9.1 më sipër, ortakët e tjerë mund të vendosin të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për të blerë kuotën, duke ia komunikuar qëllimin e tyre ortakut. Në rast se disa ortakë vendosin të ushtrojnë të drejtën e parablerjes, kuota do të ndahet mes tyre në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë. Transferimi i kuotës do të kryhet në përputhje me parashikimet e këtij Statuti, brenda dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi që i dërgohet ortakut për pranimin e ofertës për blerjen e kuotës.

9.4 Në rast se brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor ortaku nuk merr asnjë komunikim nga ortakët e tjerë, këta të fundit do të konsiderohen se kanë hequr dorë nga e drejta e parablerjes dhe ortaku mund të transferojë kuotën e tij tek të tretët, me kushtin që blerësi i kuotës të jetë një person që përmbush kriteret e kompanisë, si dhe në përputhje me rregullat dhe ligjet e vendit. Për këtë qëllim, ortaku duhet të marrë më parë miratimin nga Asambleja e Ortakëve për pranimin ose jo të personit të tretë si blerës.

9.5 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga njoftimi i ortakut për blerësin e ri, Asambleja e Ortakëve do të vendosë në lidhje me miratimin apo jo të blerësit.

9.6 Vendimi i miratimit të blerësit duhet të miratohet nga Asambleja e Ortakëve me 2/3 e të gjithë Ortakëve që kanë të drejtën e votës në mbledhjen për këtë qëllim, duke marrë parasysh, përpos sa parashikohet në nenin 9.4 të statutit edhe zotërimin nga ana e blerësit të kapacitetit ekonomik, teknik dhe financiar të përshtatshëm për aktivitetin tregtar të shoqërisë, mungesën e paragjyqimeve të këtij të fundit për realizimin e objektit të shoqërisë apo konfliktin e interesit mes tij dhe shoqërisë apo ortakëve të tjerë. Ortaku që shet kuotën nuk mund të ushtrojë të drejtat e tij të votës në mbledhjen e Asamblesë që do të zhvillohet për të miratuar blerësin dhe kuota e tij nuk do të merret parasysh në llogaritjen e kuorimit të nevojshëm për mbledhjen e Ortakëve. Në rast se Ortaku që shet kuotën nuk do të jetë i pranishëm në mbledhjen e Asamblesë për të miratuar blerësin, vendimi i Asamblesë do t'i njoftohet atij brenda 24 (njëzetë e katër) orëve me shkrim nga Administratori ose drejtuesi i mbledhjes së Asamblesë.

9.7 Në rast se Asambleja nuk merr vendim brenda afatit të parashikuar në nenin 9.5 të këtij Statuti atëherë blerësi do të konsiderohet i miratuar dhe kuota mund të transferohet lirisht nga ortaku tek blerësi.

9.8 Në rastin kur miratimi i blerësit i propozuar nga Ortaku që shet kuotën, refuzohet për shkakë që shkelet etika e shoqërisë, të arsyetuara nga pjesa tjetër e ortakëve, Ortaku që shet kuotën duhet të paraqesi një kandidaturë tjetër për blerësin dhe nëse nuk ka një blerës tjetër të mundshëm, Ortaku që shet kuotën, me anë të një komunikimi me shkrim dërguar me letër rekomande Administratorit dhe ortakëve të tjerë, do ketë të drejtë të largohet nga shoqëria duke kërkuar likuidimin e kuotës së tij. Në rast largimi të ortakut, do të zbatohen procedurat dhe kriteret e vlerësimit të parashikuara sipas këtij statuti.

9.9 Në rastin kur blerësi alternativ miratohet nga Asambleja e Ortakëve, atëherë transferimi i kuotës do të kryhet me çmimin, procedurat dhe kushtet e përcaktuara në letrën rekomande me kthim

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Albanian YouTubers" shpk

përgjigje dërguar sipas nenit 9.1 dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e vendimit të Asamblesë së Ortakëve, ose brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit. Në rast se transferimi i kuotës nuk kryhet sipas kushteve dhe afateve si më sipër, miratimi i Blerësit do të konsiderohet i revokuar dhe çdo shitblerje e mundshme e kryer do të jetë e pavlefshme për Shoqërinë.

9.10 Përrjashtim nga e drejta e parablerjes do të bëhet vetëm në rastin e dhurimit të kuotave për pjesëtarët e familjes së ortakëve (fëmijët dhe/ose bashkëshortëve përkatës).

Neni 10

10.1 Në rast vdekjeje të njërit prej ortakëve, do të ushtrohet e drejta e trashëgimisë. Ndërsa në rastin kur trashëgimtarët vendosin të shesin pjesën e trashëguar do ti nënshtrohen procedurës duke respektuar të drejtën e parablerjes ndaj ortakëve të tjerë, sipas nenit 9 të këtij statuti.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 11

Asambleja e Ortakëve

- 11.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 11.2 Asambleja e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- 11.2.1 përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - 11.2.2 ndryshimet e statutit;
 - 11.2.3 emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
 - 11.2.4 emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - 11.2.5 përcaktimin e shpërblimeve për punonjesit,
 - 11.2.6 mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - 11.2.7 miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - 11.2.8 zmadhimin dhe zvogëllimin e kapitalit;
 - 11.2.9 pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - 11.2.10 përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - 11.2.11 riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - 11.2.12 miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - 11.2.13 çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 11.3 Ortaku mund të përfaqësohet në mbledhje, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 11.4 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në mbledhje përvetse kur është edhe vete Ortak.
- 11.5 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Ortakëve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Ortakëve

- 12.1 Asambleja e Ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë dërguar nga Administratori i shoqërisë me postë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike në adresat e ortakëve të njoftuara për këtë qëllim. Njoftimi me shkresë apo me postë elektronike duhet të përmbajë

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Albanian YouTubers" shpk

- vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 12.2 Kur Asambleja e Ortakëve nuk është thirrur sipas pikës 1, ajo mund të marrë vendime të vlefshme nëse të gjithë ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar që do të jenë të pranishëm dhe janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 12.3 Asambleja e Ortakëve mbledhet të paktën një herë në vit çdo datë 31 janar.
- 12.4 Asambleja mund të mbledhet në vendin e caktuar në njoftim dhe nëse nuk do të përcaktohet një vend për këtë qëllim mbledhja mund të zhvillohet përmes telekonferencës, përmes aplikacioneve për këtë qëllim. Në një rast të tillë, vendi i mbajtjes së mbledhjes do të konsiderohet selia e shoqërisë.
- 12.5 Gjatë Asamblesë caktohet me votim të thjeshtë të ortakëve të pranishëm në mbledhje një ortak për të qenë Kryesuesi. Kryesuesi zgjedh sekretarin e tij gjatë Asamblesë. Sekretari mund të jetë edhe administratori i shoqërisë, në rast se administratori nuk është njëkohësisht ortak. Kryesuesi mban procesverbalin i cili në fund të Asamblesë firmoset nga sekretari dhe të gjithë ortakët. Procesverbali përmban datën dhe vendin e Asamblesë, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, si dhe diskutimet e zhvilluara. Procesverbali i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- 12.6 Ortakët e shoqërisë mund të mbledhen edhe në mbledhje të jashtëzakonshme duke respektuar parashikimet e këtij neni për shkaqe të cilat konsiderohen si urgjente apo të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë.

Neni 13 Kuorumi

- 13.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme me të paktën 51% të votave vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50% për qind të kuotave.
- 13.2 Në rastin kur Asambleja duhet të vendosë për çështje, të tilla si ndryshimi i statutit, çështje që lidhen me ndonjë nga ortakët, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm me $\frac{3}{4}$ e votave nëse ortakët që zotërojnë 80% të kuotave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.
- 13.3 Nëse Asambleja nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas mbledhjes paraardhëse, me të njëjtin rend dite.

Neni 14 Marrja e Vendimeve

- 14.1 Asambleja vendos me të paktën 51% të votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje si:
- 14.1.1.1 përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - 14.1.1.2 emërimi dhe shkarkimi i administratorit;
 - 14.1.1.3 emërimi e shkarkimi i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - 14.1.1.4 përcaktimi i shpërblimeve;
 - 14.1.1.5 mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - 14.1.1.6 përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - 14.1.1.7 miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
- 14.2 Çdo ndryshim statuti vendosur sipas nenit 13.2 të këtij statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të pasqyruar ndryshimet në ekstraktin historik të shoqërisë.

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Albanian YouTubers" shpk

Neni 15
Përfashtimi nga e Drejta e Votës



- 15.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja merr vendim për:
- vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 15.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 16
Administrimi

- 16.1 Asambleja emëron një ose më shumë persona si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 1 (një) vit, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 16.2 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 16.3 Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 16.4 Administratori i parë i shoqërisë emërohet shtetasi:

Anaid Kaloti, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BI3349245, me numër personal identifikimi ISO709072G, i datëlindjes 09.07.1985, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, në adresën: Rruga Skënderbeg, Vila 1, me afat emërimi 1 (një) vjeçar, me të drejtë ripërsëritje duke filluar nga data e emërimit.


Specimeni i nënshkrimit



Neni 17
Kompetencat e Administratorit

- 17.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakëve;
 - përfaqësojë shoqërinë tregtare në raport me të tretët;
 - kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - përgatisin me ekspertin kontabël dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Ortakëve për miratim;
 - krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - punësoni punëmarrës për mbarëvajtjen e projekteve dhe përfundimin në kohë të tyre, në zbatim të Kodit të Punës dhe duke ju referuar pagave të tregut, nëse vlerësohet si e

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Albanian YouTubers" shpk



- domosdoshme dhe justifikohet punësimi i punëmarrësve duke marrë në konsideratë gjendjen financiare të shoqërisë;
- i) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
 - j) kryen pagesa në të mirë të shoqërisë dhe të justifikuara me dokumentacionin përkatës, pa marrë më parë miratimin me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, por dakordesine me e-mail pasi të jete raportuar si i domosdoshëm dhe me oferten bashkelidhur deri në vlerën 500.000 (pesëqind mijë)lekë
- 17.2 Administratori është i detyruar të thërrasi Asamblenë e Ortakëve, në rastet kur:
- 17.2.1 sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktiviteti i shoqërisë nuk i mbulon detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
 - 17.2.2 shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
 - 17.2.3 shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 17.3 Nëse Asambleja e Ortakëve emëron një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 17.4 Asambleja e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 18 Përgjegjësitë e Administratorit

- 18.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 18.2 Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga Asambleja e Ortakëve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 18.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
- 18.3.1 të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - 18.3.2 të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - 18.3.3 të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - 18.3.4 të parandalojë dhe mënjanëjë rastet e konfliktit, prezant apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - 18.3.5 të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 18.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, mirë përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 18.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kuri shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Albanian YouTubers" Shpk

- 18.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- 18.6.1 u kthen ortakëve kontributet;
- 18.6.2 u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- 18.6.3 u shpërndan aktivet shoqërisë;
- 18.6.4 lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- 18.6.5 jep kredi.
- 18.7 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të kallëzojnë penalisht administratorin.
- 18.8 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR, EKSPERTËT

Neni 19 Viti Financiar

- 19.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 20 Ekspertët

- 20.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 20.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollat periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'jua paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

Neni 21 Fitimi

- 21.1 Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, pasi zbriten të gjitha shpenzimet, si edhe fondet e lëna rezervë për nxitje ekonomike, për investime për reklama tregtare, ndahen ndërmjet ortakëve në përputhje me përqindjen e kapitalit që zotëron secili ortak.
- 21.2 Pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, Asambleja e Ortakëve vendos edhe për fitimet e realizuara. Asambleja mund të vendosë që me këto fitime të zmadhojë kapitalin e regjistruar, të rrisi rezervat statutorë ose të shpërndajë dividend.

Statut i shoqërisë me përtypje të kufizuar
"Albanian YouTubers" shpk

- 21.3 Në përputhje me nenin 77 të ligjit 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", përpara se të vendoset për shpërndarje dividendi, administratorët lëshojnë çertifikatë të aftësisë paguese. Kjo çertifikatë lëshohet vetëm nëse pas pagimit të dividendit, aktivet e shoqërisë i mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve në vazhdim.
- 21.4 Ortakët e huaj, mund të transferojnë lirisht fitimet e realizuara jashtë Shqipërisë, në përputhje me dispozitat ligjore shqiptare në fuqi.

Neni 22

Krijimi i Rezervave

- 22.1 Mbas miratimit të pasqyrave financiare, Asambleja krijon rezerva statutare. Rezerva statutare duhet të jetë për çdo vit jo më pak se 5% e fitimit vjetor. Kur këto rezerva të kapin shumën sa 10% të kapitalit themeltar, Asambleja e Ortakëve mund të mos krijojë më rezerva.

KREU V

PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 23

Prishja dhe Likuidimi

- 23.1 Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:
- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
 - me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin;
 - me vendim të gjykatës
- 23.2 Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej shoqërisë emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".
- 23.3 Prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Neni 24

Riorganizimi i Shoqërisë, Bashkimi, Ndarja

- 24.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 25

Baza Ligjore

- 25.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Albanian YouTubers" shpk

25.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 26
Mosmarrëveshjet

26.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje që lind midis ortakëve, shoqërise e palëve të treta, do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë .


Ky Statut u firmos në 3 (tre) kopje të barabarta në gjuhën shqipe

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Albanian YouTubers" Shpk


ANAID KALOTI

Anaid Kaloti



ERION ZEQRIRAJ

Erion Zeqiraj


JETMIR SALAJ

Jetmir Salaj


KLEANTHI HYSA

Kleanthi Hysa


VESEL KURTISHAJ

Vesel Kurtishaj
